



Republika e Kosovës
Komuna e Drenasit (Gllogoc)
Kuvendi i Komunës

02 Nr. 353/02-5041 dt. 29.01. 2024



Bazuar në nenin 11,12, dhe 40 të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 34 të Statutit të Komunës së Drenasit, dhe nenit 26 të Rregullorës (QRK) Nr.09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronë së Paluajtshme të Komunës. Kuvendi i Komunës së Drenasit (Gllogoc) në mbledhjen e rregullt të mbajtur me datë: 29.01.2024, miratoi këtë:

V E N D I M

Për caktimin e lokacionit për realizimin e Projektit për ndërtimin e objektit të paralelës së shkollës SHFMU "Rasim Kiqina" në Shtrubullovë

I.

MIRATOHET propozimi për caktimin e lokacionit për realizimin e Projektit për ndërtimin e objektit të paralelës së shkollës SHFMU "Rasim Kiqina" në Shtrubullovë, nga ana e Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit – MASHTI në fshatin Shtrubullovë.

II.

Lokacioni ku do të ndërtohet objekti i paralelës së shkollës SHFMU "Rasim Kiqina" në Shtrubullovë ka këto karakteristika:

Është pronë e Komunës së Drenasit, dhe është në zonën kadastrale në Shtrubullovë, në pjesën e ngastrës kad.202-0, me $S = 42964 \text{ m}^2$, e cila sipas PZHK-së dhe Hartës Zonale është e planifikuar si tokë ndërtimore, sipërfaqja e nevojshme për realizimin e këtij projekti është 18500 m^2 .

II.

Qëllimi për caktimin e këtij lokacioni ka të bëjë me realizimin e Projektit për ndërtimin e objektit të paralelës së shkollës SHFMU "Rasim Kiqina" në Shtrubullovë, ku parcela P-70315077-00202-0, dhe sipas PZHK-së dhe Hartës Zonale janë planifikuar për ndërtim.

III.

Obligohet Drejtoria për Gjeodezi Kadastër dhe Pronë, që të përfundojë të gjitha procedurat e nevojshme gjeodezike, kadastrale dhe pronësore, që nevojiten për regjistrimin në RDPP.

IV.

Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen: Kryetari i Komunës, dhe Drejtoria për Gjeodezi, Kadastrë dhe Pronë e Komunës së Drenasit.

V.

Pjesë përbërëse e këtij vendimi janë: Skica, Kopja e planit dhe Çertifikata e njësisë kadastrale.

VI.

Me këtë Vendim do të njoftohen organët kompetente të Komunës së Drenasit.

VII.

Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë nga dita e regjistrimit dhe vlerësimit të ligjshmërisë nga MAPL-ja, si dhe 7 ditë nga publikimi në Ueb faqen zyrtare të Komunës.

Vendimi i dërgohet:

- Zyrës së Kryetarit ;
- Drejtorisë Përkatëse;
- Zyrës së Kuvendit;
- Arkivit

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës


Milaim Hajdari

A r s y e t i m

Sipas kërkesës së MASHTI-së e cila edhe është donator i këtij projekti, punimet për ndërtimin e objektit të paralelës së shkollës SHFMU'Rasim Kiqina' në Shtrubullovë, andaj për tu kryer punët sipas standardeve të kërkuara është e domosdoshme të miratohet ky vendim dhe të caktohet lokacioni i shënuar më lartë, për arsye të realizimit të projektit për ndërtimin e objektit të paralelës së shkollës 'Rasim Kiqina'.

Pra projekti për ndërtimin e objektit të paralelës së shkollës SHFMU'Rasim Kiqina' në Shtrubullovë, do të financohet nga MASHTI, vlenë të ceket se në parcelen 202-0 është lokacion i planifikuar për ndërtim dhe gjindet në lokacion të përshtatshëm për të gjithë komunitetin e zonës, prandaj edhe është zgjedhur ky lokacion për ndërtimin e paralelës së shkollës 'Rasim Kiqina' në Shtrubullovë.

Drejtorati për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë ka caktuar ekipin profesional i cili ka përcaktuar dhe ka bërë matjet gjeodezike të lokacionit për ndërtimin e objektit të paralelës së shkollës SHFMU'Rasim Kiqina' në Shtrubullovë, sipas kërkesës së DA-së ka përgaditur dokumentet e nevojshme gjeodezike.

Pjesë përbërse e këtijë propozim-vendimi janë edhe Çertifikata mbi të drejtat e pronës, kopja e planit dhe skica e propozuar e lokacionit.

Vjosa Ahmetaj

Reply all |

Fri 2/9, 3:12 PM

Milaim Hajdari; Jeton Qela; Besim Murtezani; Xhevat Tafa; Liridona Ajazi

You forwarded this message on 2/13/2024 9:07 AM

Label: DelTenYOldEm (10 years, 2 months, and 10 days) Expires: 4/17/2034 3:12 PM

I nderuar,

Bazuar në Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 06/2021 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores (QRK) Nr. 10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, (shtojca II - Aktet e organeve të komunës që nuk i nënshtrohen shqyrtimit të detyrueshëm apo të rregullt të ligjshmërisë), Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal pas shqyrtimit të përmbajtjes së akteve të Kuvendit të Komunës së Gllogocit, si në vijim:

Vendimin 02 Nr. 353/02-5041 për caktimin e lokacionit për realizimin e Projektit për ndërtimin e objektit të paraleles së shkollës SHFMU "Rasim Kiqina" në Shtrubullojë, vendim i datës 29.01.2024, vlerëson se akti i komunës nuk i nënshtrohet shqyrtimit të detyrueshëm të ligjshmërisë.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal mbetet në dispozicion të Komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejshme në lidhje me këtë vlerësim.

Me respekt,

Vjosa Ahmetaj

Zyrtare e Lartë për Monitorim të Komunave

Departamenti Ligjor dhe Monitorim të Komunave – MAPL

Tel: 038 200 64 144

E-mail: vjosa.ahmetaj@rks-gov.net

Adresa: Pallati i Shtypit Ish-Rilindja